Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

1. Dorashkat e saldimit duhet të jenë me material lekure dhe me zgjatim në kyce për mbrojtje me të mirë.
2. Përparësia e punës së lekures duhet të jetë material lekure dhe duhet të ketë rripa të rregullueshëm. Duhet të ketë një gjatësi të pakten 900 mm. Qepja e përparësës duhet të jetë me teknologjinë "Kevlar".
3. Syzet e saldimit duhet të jenë të lehta dhe duhet të kenë strukture të bute PVC. Duhet të jenë të modeluara me dy modalitete shikimi, modalitetin për saldimit dhe modalitetin për shikim të qartë. Lentet për saldimit duhet të kenë mundësi të palosjen për të bërë të mundur përdorimin e lenteve të tejdukshme.
4. Maska e saldimit duhet të jetë plotësisht automatike dhe gjendja e erresimit duhet të jetë sipas DIN 9 – 13. Koha e erresimit të xhamit duhet të jetë jo më shumë se 0.05 ms. Maska duhet të furnizohet me bateri Li dhe me rreze diellore. Koha e rikthimit në gjendje fillestare duhet të jetë e rregullueshme dhe midis diapazonit 0.3 – 0.8 sec. Gjithashtu ndryshimi I ndjeshmerisë së xhamit duhet të bëhet me anë të një butoni të instaluar në trupin e maskës. Maska duhet të përdoret për saldime MIG, TIG, me elektrode si dhe për prerje me "PLASMA".
5. Libri I Shërbimit duhet të jetë me 30 flete dhe të pakten me 1 kopje për secilen fletë.
6. Libri I Kontrollit duhet të jetë me 30 flete të pakten me 1 kopje për secilen fletë.

-
7. Sharra e dores per derrase duhet te kete nje gjatesi te tehut preres te pakten 390 mm. Sharra duhet te kete minimalisht 6 dhembe per inch. Duhet te jete e pajisur me doreze, ndersa tehu dhe duhet te jete me material Celiku me Mangan.
 8. Dara e telit duhet te kete nje gjatesi jo me pak se 170 mm. Dara duhet te kete material celik te farketuar dhe te nikeluar. Krahet e dares duhet te jene me doreza te rehatshme.
 9. Pinca duhet te jete material celiku krom vanadium dhe me doreze kunder rreshkitjes. Gjatesia minimale e saj duhet te jete 175 mm.
 10. Kazma e gurit duhet te kete peshe jo me te madhe se 2.1 kg. Nje krah I kazmes duhet te jete me maje per terrene shkembore dhe krahu tjetër duhet te jete I sheshte per terrene me te buta. Materiali I kazmes duhet te jete celik I farketuar.
 11. Bishti i kazmes duhet te jete material druri.
 12. Lopata e celikut duhet te jete me gjeresi minimalisht 28cm.
 13. Bishti i lopates duhet te jete material druri.
 14. Kutia e ndihmes se shpejte duhet te jete e pajisur me kompresa sterile, fasho te madhesive te ndryshme, dorashka njeperdorimshe, garza sterile, pershtates per frymemarrje artificiale dhe udhezime per ndihmen e pare.
 15. Shiriti I kufizimit duhet te jete me material PVC, ngjyre e kuqe me te bardhe. Shiriti duhet te jete rezistent ndaj ujit, rezistent ndaj rrezeve ultra-viollece dhe duhet te kete rezistence te mire ndaj gerryerjes. Duhet t'i rezistojte temperatureve deri ne 40°C. Gjithashtu shiriti duhet te kete dhe faktorin e zgjatimit ne keputje te pakten 145%.
 16. Teli i barit duhet te kete diameter minimumi 1.5 mm dhe duhet te duroje nje force ne terheqje te pakten 350 Mpa. Duhet te kete elasticitet te mire dhe te jete me material me karbon te ulet.
 17. Manometri duhet te jete i pershtatshem per te matur presione gazi, presione pneumatike dhe presione hidraulike. Matja duhet te behet me ane te metodes "Bourdon". Foleja e montimit duhet te jete bronz. Duhet te duroje nje presion prej te pakten 25 bar dhe duhet te punoje ne temperature te pakten -25°C deri ne 60°C. Manometri duhet te kete nje dalje ¼ per filetimin me pajisjet perkatese. Treguesi duhet te tregojte ne te dyja njesite, bar dhe psi. Manometri duhet te jete ne perputhje me standardin DIN 16007 ose ekuivalent.
 18. Zorra thithese per pompe duhet te kete diameter 3" dhe trashesi te pakten 75 mm. Duhet te duroje nje presion jo me te vogel se 400 PSI. Materiali i zorres duhet te jete PVC e cilesise se larte me spirale. Duhet te perdoret ne fusha te ndryshme aplikimi si psh ne furnizimin e rregullt me uje ose sisteme drenazhimi, punime te ndryshme ndertimi ose civile. Duhet te kete nje rreze perthyerje te pakten 210 mm.
 19. Sprajti I bojes duhet te jete ngjyre e kuqe ne paketime 400 ml. Duhet te thahet shpejt, te kete mbulim te mire, duhet te jete per perdorim te brendshem dhe te jashtem. Duhet te jete i afte per perdorim ne dru, metal dhe shume siperfaqe te tjera.
 20. Sprajti kunder ndryshkut duhet te siguroj nje mbroitje ndaj ndryshkut, duhet te kete aftesi te fuqishme lubrifikimi te dadove, bulonave dhe veglave te ndryshme. Duhet te ofroje mundesi per heqjen e ujit ne paisje qe kane rene ne kontakt me ujin. Te jete i pa tretshem ne uje, dhe ne momentin e aplikimit te krijojte nje shtrese mbrojtese te pakten 40µm. Presioni i daljes duhet te jete minimalisht 6 bar. Temperatura e ndezjes duhet te jete minimalisht 55°C. Rezistenca dielektrike duhet te jete te pakten 35000V.
 21. Defkoni duhet te perdoret per te eliminuar rrjedhjet ne filetimet hidraulike.

-
22. Litari per ngritje 4 ton duhet te jete rrip neiloni ose poliestre ne perputhje me standardin EN 1492-1 dhe direktiven 2006/42/EC ose ekuivalente. Duhet te jete I modeluar ne menyre te tille qe te duroje nje peshe minimumi 3.8 Ton per lidhje te drejtperdrejte dhe minimumi 7.8 Ton per lidhje ne forme "U".
 23. Litari per ngritje 1.5ton duhet te jete rrip neiloni ose poliestre ne perputhje me standardin EN 1492-1 dhe direktiven 2006/42/EC ose ekuivalente. Duhet te jete I modeluar ne menyre te tille qe te duroje nje peshe minimumi 1.5 Ton per lidhje te drejtperdrejte dhe minimumi 3.8 Ton per lidhje ne forme "U".
 24. Matrapiku duhet te jete te pakten 1500W, dhe te kete nje energji goditjeje minimumi 20J, nr. maksimal i rrotullimeve nuk duhet te jete me i ulet se 1900 rrot/min. Pesha maksimale duhet te jete jo me shume se 12kg. Matrapiku duhet te jete modeluar per te suportuar punto me diameter deri ne 50 mm. Duhet te kete nje kabell me gjatesi minimumi 5m. Matrapiku duhet te jete i pajisur me sistem sigurie automatike per te ndaluar punen ne rast se matrapiku ndalon ne rast avarie. Te jete I pajisur me sistem per pune konstante dhe te adaptohet me materialin e aplikimit. Duhet te kete doreze per zbutjen e vibrimit.
 25. Pompa e grasos duhet te kete ne strukturen e vet nje mekanizem karikimi dhe suste rezistente per nje mbushje te njetrajtshme. Koka e pompes duhet te jete e ndertuar me material te derdhur per rezistence te larte dhe jetegjatesi te larte. Doreza e pompes duhet te jete me material ergonomik. Pompa duhet te kete edhe pajisje ndihmese si: tubin e shperndarjes me perberje celiku me trashesi jo me te vogel se 1.1 mm. Pompa duhet te kete presion pune te pakten 300Bar.
 26. Lama duhet te jete te pakten 100mm e gjate. Trashesia e lames duhet te jete te pakten 0.5 cm ndersa gjeresia duhet te jete 18 mm.
 27. Thika bisturi per kablllo duhet te kete gjatesi jo me pak se 10 cm, ndersa gjeresia nuk duhet te jete me e madhe se 40 mm. Thika duhet te jete e pajisur me te pakten nje lame. Duhet te kete buton te sheshte dhe system vete-kyces.
 28. Morseta per kavo celiku 8mm duhet te jete e galvanizuar. Morseta duhet te jete sipas standardit DIN741 ose ekuivalent. Morseta nuk duhet te jete me e gjere se 15 mm dhe primitivi i dy vrimave fiksuese duhet te jete te pakten 15 mm.
 29. Litari me diamter 12 mm duhet te jete me material neiloni me 8 gersheta dhe duhet te kete nje peshe jo me te madhe se 90 gr/m. Litari duhet te jete i afte te mbaje nje force te pakten deri ne 23 KN.
 30. Celesi papagall I madh duhet te kete madhesi 18" dhe duhet te kete doreze gize te mbuluar me gome, duhet te kete nofull material Krom-Molibden. Gjatesia duhet te jete minimumi 440mm. Hapja maksimale duhet te jete te pakten 58 mm.
 31. Aparati per ngjitjen e tubave duhet te jete per ngjitje tubash PPR, PP, HDPE etj. Aparati duhet te perdoret per diametra tubash nga 90 deri ne 315 mm. Gjithashtu pajisja duhet te perdoret per te ngjitur edhe rakorderi te ndryshme plastike si brryla, rakorderi ne forme "T" dhe "Y". Koha per te arritur temperaturen e shkrirjes nuk duhet te jete me e madhe se 21 minuta. Temperatura e punes duhet te jete jo me pak se 180 °C dhe temperatura maksimale jo me shume 275 °C. Pajisja duhet te jete modeluar per te punuar ne temperatura ambienti te pakten -10 °C deri ne 40 °C. Furnizimi me energji elektrike duhet te behet me ane te rrjetit nje fazor 220V dhe duhet te kete nje fuqi maksimale jo me te madhe se 4600W. Pllaka e ngjitjes duhet te jete me nje shtrese PTFE, duhet te jete e pajisur me nje termometer ne trup dhe me nje rregullator elektronik temperature me saktesi ± 1 oC. Nofullat shtrenguese duhet te fiksohen me aparatit me nje sistem kyces te

shpejte dhe “inteligjent”. Pajisja duhet te jete e ndertuar ne perputhje me standardin ISO 12176-1 ose ekuivalent. Aparati duhet te jete I pajisur me te pakten 4 fasheta shtrenguese dhe te pakten dy cilindra hidraulik. Fashetat duhet te jene te komandueshme nga nje leve kontrolli.

32. Lazeri per matje duhet te jete material gome dhe ABS. Duhet te jete I lehte ne perdorim dhe duhet te suportoje matjen e vellimeve, siperfaqeve dhe te distancave te ndryshme. Duhet te jete I pajisur me nje drite ndihmese per te krijuar lehtësi ne terrene te veshtira. Aparati duhet te mundesoje matje sipas sistemit imperial dhe sipas sistemit SI. Diapazoni I matjes duhet te jete jo me pak se 18m dhe saktësia e matjes nuk duhet te kaloje me shume se 2.5 mm. Aparati duhet te funksionojë me bateri te zevendesueshme dhe duhet te jete I afte te kryeje jo me pak se 4800 matje me nje set baterish. Produkti duhet te jete I pajisur me markimin CE.
33. Disku prerës duhet te sherbeje per prerje asfalti dhe betoni. Disku duhet te kete nje diameter 450 mm. Saldimi I dhembeve duhet te jete I forte, I salduar me lazer dhe duhet te ofroje siguri gjate punimit. Disku duhet te perdoret ne sharra me uje dhe vrima e boshtit te instalimit duhet te jete 25.4 mm
34. Sharra per prerje tubash duhet te jete me motorr me djegie te brendshme dhe nuk duhet te jete me pak se 45 cm³. Sharra duhet te jete e afte te prese tuba me nje diameter maksimal deri ne 440 mm. motorri duhet te jete 2-kohesh dhe fuqia e tij duhet te jete te pakten 1.8 kW. Depozita e vajit nuk duhet te jete me e vogel se 250 ml ndersa depozita e karburantit duhet te jete te pakten 530 ml.
35. Komplet i me celesa kriketo duhet te jete I perbere nga doreza me koke ½” dhe me pjese fundore ergonomike. Materiali I dorezes duhet te jete Chrome – Vanadium dhe ingranazhi I rrotullimit duhet te jete me 72 dhembe. Ne set duhet te perfshihet edhe nje krah zgjatues me nje gjatesi jo me pak se 120 mm. Seti duhet te kete te pakten 10 koka te madhesive te ndryshme nga 10 deri ne 22 mm.
36. Trokoja e madhe duhet te kete nje fuqi jo me te vogel se 2300W dhe jo me pak se 6300 rrotullime per minute ne regjimin pa ngarkese. Disku prerës qe mund te instalohet ne troko duhet te jete deri ne 230mm dhe boshti per shtrengimin e diskut duhet te jete M14. Trokoja duhet te kete edhe nje doreze ergonomike e cila mund te montohet ne tre pozicione te ndryshme, majtas, djathtas ose ne pozicion vertikal. Ne paketim duhet te perfshihet edhe nje set shtese me “karboncina”.
37. Trokoja e vogel duhet te jete me shpejtesi te ndryshueshme dhe xhirot duhet te jene te pakten 4900 rrotullime per minute deri ne 120000 rrot/min. Fuqia e trokose duhet te jete midis 850 – 950W dhe duhet te suportojë nje disk prerës deri ne 130 mm. Boshti I montimit te diskut duhet te jete M14. Trokoja duhet te jete e pajisur me nje doreze shtese ergonomike te levizshme.
38. Elektriku I dores duhet te siguroje nje ndricim per largesi deri ne minimumi 270 m dhe nje ndricim jo me te vogel se 530 Lumens. Elektriku duhet te jete I ndertuar me material alumini per te siguruar nje jetegjatesi me te larte. Klasa e mbrojtjes duhet te jete te pakten IP65. Elektriku duhet te kete nje autonomi jo me te vogel se 7 ore dhe duhet te funksionojë me 3 bateri 1.5V secila. Produkti duhet te jete I pajisur me markimin CE.
39. Fshesa duhet te jete me fije te forta metalike ose plastike me qellim aplikimin ne siperfaqe te veshtira. Duhet te kete mundesi per t'u bashkuar me bisht te gjate. Permasat e fsheses duhet te jene te pakten 40×6×16 cm. Bishti I fsheses duhet te jete material druri ose metalik dhe duhet te kete nje rezistence te larte kunder thyerjes. Gjatesia e bishtit nuk duhet te jete me e vogel se 135 cm.

-
40. Llamba duhet te jete e tipit LED dhe duhet te kete xogel E27. Kendi I ndricimit duhet te jete te pakten 210°. Temperatura e ndricimit duhet te jete 6500K dhe indeksi I paraqitjes se ndricimit nuk duhet te jete me I vogel se 80. Llamba duhet te kete nje jetegjatesi jo me te vogel se 15.000 ore pune.
 41. Bullona duhet te jete madhesi M20 dhe duhet te jete material celiku I grades 8.8. Gjatesia e bullones duhet te jete 100 mm. Trashesia e kokes shtrenguese duhet te jete te pakten 12 mm dhe distanca nga kulmi ne kulm duhet te jete 32.95 mm. Pjese e bullonit duhet te jete edhe rondelja perkatese e modeluar sipas standardit DIN125. Bullona duhet te jete ndertuar ne perputhje me standardin GB5781 dhe DIN933.
 42. Seti me celesa fiso duhet te jete i prodhuar me celik Cr-V dhe i kromuar. Seti duhet te permbaje madhesite nga 6 deri ne 32 mm.
 43. Seti me celesa poligon duhet te jete i perbere nga 8 celesa me madhesi te ndryshme dhe duhet te jete prodhuar ne perputhje me standardin DIN838 ose ekuivalent. Materiali I perdorur duhet te jete Chrome – Vanadium. Seti duhet te permbaje madhesite nga 6mm deri ne 22mm
 44. Litari I amiantit duhet te jete me permasa 10 x 10 mm dhe duhet te duroje temperatura deri ne 250oC. Presioni max. I lejuar duhet te jete te pakten 330 bar. Litari duhet te jete I ndertuar per perdorim ne pompa dhe ne saracineska.
 45. Celesi papagall I vogel duhet te kete madhesi 14" dhe duhet te kete gjatesi minimumi 330 mm dhe jo me shume se 370 mm. Gjeresia e pergjithshme nuk duhet te jete me shume se 65 mm ndersa hapja maksimale duhet te jete te pakten 49 mm. Te kete koke hekuri qe te mundesoje hapjen dhe mbylljen e lehte dhe doreze te veshur me gome per kapje stable.
 46. Menteshat duhet te jene material celiku dhe duhet te gjejne perdorim ne industrine e rende. Pesha max. qe duhet te mbaje mentesha duhet te jete te pakten 75 kg. Mentesha duhet te fiksohet me objektin me ane te saldimit. Gjatesia e plote e menteshes nuk duhet te jete me shume se 9.3 cm dhe gjatesia e secilit krah duhet te jete te pakten 40 mm. Diametri I kunjes duhet te jete jo me pak se 19 mm. Levizja e menteshes duhet te kryhet me ane te kushinetes me sferë.
 47. Elektroda 1.6 mm duhet te perdoret per saldimit celiku dhe duhet te jete e afte te perdoret ne te gjitha pozicionet e saldimit, horizontale dhe vertikale. Elektroda duhet te jete e afte te funksionojë ne aparate saldimit me rryme AC dhe DC, rryma e shkrirjes duhet te jete jo me shume se 55A si dhe duhet te siguroje lehtesi ne heqjen e skorjeve. Perberja kimike duhet te jete e perbere nga 0.03% - 0.04% Squfur, 0.4% - 0.45% Silic, 0.5% - 0.6% Mangan dhe 0.07% Karbon. Zgjatja e elektrodës ne varesi te saldimit duhet te jete jo me pak se 24%, forca ne terheqje duhet te jete jo me pak se 490 Mpa dhe jo me shume se 555 Mpa. Elektroda duhet te rezistojë nje force ne thyerje jo me shume se 425 Mpa. Produkti duhet te jete ne perputhje me standardin EN ISO 2560-A dhe AWS A5.1 ose ekuivalent. Elektrodat duhet te jene ne paketim me peshe jo me te vogel se 1.5 kg per pako.
 48. Elektroda 2 mm duhet te perdoret per saldimit celiku dhe duhet te jete e afte te perdoret ne te gjitha pozicionet e saldimit, horizontale dhe vertikale. Elektroda duhet te jete e afte te funksionojë ne aparate saldimit me rryme AC dhe DC, rryma e shkrirjes duhet te jete jo me shume se 70A si dhe duhet te siguroje lehtesi ne heqjen e skorjeve. Perberja kimike duhet te jete e perbere nga 0.03% - 0.04% Squfur, 0.4% - 0.45% Silic, 0.5% - 0.6% Mangan dhe 0.07% Karbon. Zgjatja e elektrodës ne varesi te saldimit duhet te jete jo me pak se 24%, forca ne terheqje duhet te jete jo me pak se 490 Mpa dhe jo me shume se 555 Mpa. Elektroda duhet te rezistojë nje force ne thyerje jo me shume se 425 Mpa. Produkti duhet te jete ne perputhje me standardin EN ISO 2560-A dhe AWS

A5.1 ose ekuivalent. Elektrodat duhet te jene ne paketim me peshe jo me te vogel se 1.8 kg per pako.

49. Elektroda 4 mm duhet te perdoret per saldimit celiku dhe duhet te jete e afte te perdoret ne te gjitha pozicionet e saldimit, horizontale dhe vertikale. Elektroda duhet te jete e afte te funksionoj ne aparate saldimit me rryme AC dhe DC, rryma e shkrirjes duhet te jete jo me shume se 185A si dhe duhet te siguroje lehtesi ne heqjen e skorjeve. Perberja kimike duhet te jete e perbere nga 0.03% - 0.04% Squfur, 0.4% - 0.45% Silic, 0.5% - 0.6% Mangan dhe 0.07% Karbon. Zgjatja e elektodes ne varesi te saldimit duhet te jete jo me pak se 24%, forca ne terheqje duhet te jete jo me pak se 490 Mpa dhe jo me shume se 555 Mpa. Elektroda duhet te rezistoj nje force ne thyerje jo me shume se 425 Mpa. Produkti duhet te jete ne perputhje me standardin EN ISO 2560-A dhe AWS A5.1 ose ekuivalent. Elektrodat duhet te jene ne paketim me peshe jo me te vogel se 4.3 kg per pako.
50. Drynat e medhenj duhet te jene material bronzi dhe me hallke celiku te kromuar. Madhesia e drynit duhet te jete 60 – 62 mm. Pjesa e brendshme e drynit duhet te jete kunder ndryshkut. Dryni duhet te jete I pajisur me te pakten 2 celesa.
51. Drynat e vegjel duhet te jene material bronzi dhe me hallke celiku te kromuar. Madhesia e drynit duhet te jete 30 mm. Pjesa e brendshme e drynit duhet te jete kunder ndryshkut. Dryni duhet te jete I pajisur me te pakten 2 celesa.
52. Furca e bojës duhet te jete rezistente ndaj tretesirave acide dhe duhet te kete nje doreze ergonomike per te krijuar lehtesi ne perdorim. Gjatesia e qimeve nuk duhet te jete me pak se 5.5 cm ndersa gjeresia e furces duhet te jete te pakten 50 mm. Trashesia e furces duhet te jete minimumi 1.8 cm. Qimet duhet te jene te fiksuara me bishtin me ane te nje pllake metalike.
53. Rulat e bojës duhet te jene gjatesi jo me te madhe se 11 cm, dhe diametri per instalimin e bishtit duhet te jete 5.5 – 5.9 mm. Rulat duhet te jene per perdorim ne boje akrilike. Gjatesia e qimeve te rulit nuk duhet te jete me shume se 5 mm.
54. Furca e telit duhet te kete nje doreze plastike dhe gjatesia e pergjithshme e furces nuk duhet te jete me shume se 10.5". Telat duhet te jene nje gjatesi 28 – 31 mm dhe duhet te jene nje diameter te pakten 0.25 mm. Gjatesia pa llogarit bishtin mbajtes duhet te jete te pakten 12.5 cm. Furca duhet te jete e pershtatshme per perdorim ne dru, metal dhe duhet te jete e afte per procese te ndryshme si heqje ndryshku, heqje boje dhe heqje te papastertive te ndryshme.
55. Cizmet duhet te jene me material PVC te aprovuara sipas standardit S1P ose ekuivalent. Duhet te jene me sholle te rehatshme. Cizmet duhet te jene kundra ujit, rezistente ndaj vajrave, acideve dhe alkalineve. Maja dhe sholla e kepuces duhet te jene me celik. Masat e cizmeve duhet te jene nga numri 39 deri ne numrin 44. Lartesia minimalisht 38cm.
56. Cizmet e gjuetise duhet te jene material plastik dhe elastik per te krijuar lehtesi punimi per operatorin. Cizmet duhet te jene te gjata deri ne kraharor dhe duhet te mos e depertojne ujin brenda. Duhet te jene te pajisura me dy rripa te rregullueshem per tu pershtatur ne gjatesi te ndryshme.
57. Mushamaja e shiut duhet te jene me material PVC dhe poliester dhe duhet te mundesoje ajrosje te shpines. Gjatesia te jene minimalisht 120cm. Trashesia minimalisht 330µm. Xhaketa duhet te jene e pajisur me shirita reflektiv.
58. Dorashkat e punes duhet te jene te pershtatshme per ngritjen e peshave dhe rezistente ndaj objekteve te mprehta. Pellemba duhet te jene materjal latekskereliev per nje kapje sa me te qendrueshme.

59. Rrobat e punes duhet te jene kombinim I materialit poliester, jo me shume se 85% dhe materialit te pambukut jo me pak se 15%. Qepjet duhet te jene te trefishta per te rritur jetegjatesine e veshjes Duhet te jene te pajisura me te pakten dy xhepa te pasem me kapak, dy xhepa ne pjesen e perparme, nje xhep anesor me kapak, xhepa per vendosjen e mbrojteseve te gjurit dhe nje mbajttese cekici. Rripat duhet te jene te rregullueshem per t'u perdorur ne gjatesi te ndryshme. Veshja duhet te kete pjese reflektive ne pjesen e perparme ne menyre qe te krijojte kushte sigurie me te larta per operatorin. Duhet te ofrohen ne madhesite S – XXXL.
60. Kepucet e punes duhet te jene te aprovuara si pas standardit SSH EN20345 ose ekuivalent dhe duhet te jene me Celik ne maje dhe ne sholle. Per shkak te perdorimit ne kantiere te ndryshme punimi keputet duhet te jene rezistente ndaj vajrave, rezistente ndaj rreshkitjes si dhe kundra vibrimit. Pjesa e sipërme duhet te jete e ndare me lekure. Masat duhet te jene nga nr. 38 deri ne nr. 44.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi i Materialeve	Njësia	Sasia
1	Dorashka profesionale saldatori	Palë	1
2	Perparese pune lekure	Cope	2
3	Syze pune mbrojtese saldimi	Palë	2
4	Maske saldimi profesionale Kokore	cope	1
5	Liber sherbimi (30 flete)	cope	30
6	Liber kontrolli (30 flete)	cope	30
7	Sharrë dore	Copë	6
8	Darë teli	Palë	3
9	Pinca	Palë	3
10	Kazëm guri	Copë	5
11	Bisht kazme	Copë	10
12	Lopatë çeliku	Copë	10
13	Bisht lopate	Copë	10
14	Kuti e ndihmes se shpejte	Set	10

15	Shirit kufizues	Copë	50
16	Tel bari	kg	20
17	Manometra 25 Bar	cope	20
18	Zorre thithese per pompe 3"	ml	40
19	Sprajte Boje	Copë	30
20	Sprajte kunder ndryshkut	Copë	30
21	Defkon për filetim I bardhe	Copë	40
22	Litar ngritje Neilon 4 Ton	Copë	2
23	Litar ngritje Neilon 1.5 Ton	Copë	2
24	Matrapik 1500 W, 1000 rpm	Copë	1
25	Pompa Graso Universale	Copë	3
26	Lama Thikash Bisturi	Pako	15
27	Thika Bisturi për Kabull	Copë	10
28	Kavallota Ø 8	Copë	20
29	Litar Neilon Ø 12 Portokalli	ml	200
30	Çeles papagall I madhe	cope	3
31	Aparate ngjites tubosh koke me koke nga dn90 deri te dn 315 dhe frezat e kompletuar	cope	1
32	Lazer (PER MATJE)	cope	1
33	Disk prerës 450MM	cope	2
34	Sharr me benzini (Prerje tubash)	cope	2
35	Komplet celsa kriketosh	SET	1
36	Trako e madhe	cope	1
37	Trako e vogel	cope	1
38	Elektrik DORE I MADHE	cope	10
39	Fshesa plastike + bishta PASTRIM DEPO	cope	10
40	Llamba 15W	cope	50
41	BULLONA + RRONDELE 20X100	cope	60
42	Komplet Çelsa FISO	SET	1
43	Komplet Çelsa POLIGON	SET	1
44	Litar amianti	ml	5
45	Çeles papagall I VOGEL	cope	2
46	Mentesha me kuzhinete per dyer	cope	20
47	elektroda 1.6 mm	Pako	30
48	elektroda 2 mm	Pako	30

49	elektroda 4 mm	Pako	30
50	Furca boje	cope	20
51	Rrula te vegjel per boje	cope	10
52	Furca teli	cope	7
53	Cizme	Palë	164
54	Cizme gjuetie	Palë	2
55	Mushama shiu	cope	164
56	Dorashka pune	Palë	164
57	Rroba pune	Palë	164
58	Kepuc pune	Palë	164

Afatet e lëvrimit: Sipas kërkeses se Shoqëris Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Lushnje

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.2.3 Kopje të vërtetuar të bilanceve, të audituara nga ekspertet kontabël të licencuar, të konfirmuara nga autoritetet përkatëse të Administratës Tatimore, të tre viteve të fundit të ushtrimit të aktivitetit, ku të paktën në dy bilancet e një pasnjeshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Akti i Ekspertizës së Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga Operatori Ekonomik vetëm në rastet kur janë në kushtet e percaktuara nga neni 41, germa 'c' e ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" (indryshuar)".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

Për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumenteve të tilla si certifikata ISO ku operatori ekonomik duhet të dëshmojë se është i pajisur me certifikatat:

ISO 9001 përfaqëson standardin ndërkombëtar unanim i njohur si standardi që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standard aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit.

Gjithashtu, këto certifikata janë të nevojshme për të vërtetuar që operatori ekonomik ofertues ushtron aktivitet në pajtueshmëri me standardet e kërkuara të cilësisë, duke garantuar në këtë mënyrë se furnizimi i mallrave do të realizohet sipas standardeve ndërkombëtare.

2.3.1 Operatori ekonomike duhet të paraqesë një deklaratë që merr përsipër transportin dhe lëvrimin e mallrave drejt ambjenteve magazinuese të Autoritetit Kontraktor

2.3.2 Operatorët Ekonomik në momentin e hapjes së ofertave, duhet të paraqesin nga një mostër për të gjithë artikujt/zërat e preventivit. Te gjithë produktet e paraqitura duhet të jenë të reja (te pa përdorura), që të kryhet sa më mirë verifikimi nëse mostrat e paraqitura i plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara ose jo. Mosparaqitja e një ose disa mostrave dhe/ose mospërbushja e specifikimeve teknike të kërkuara nga mostrat e paraqitura, përben kusht për skualifikim.

Dorëzimi i mostrave, të bëhet pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lushnje Sh.A.

Data e dorëzimit të mostrave të jetë data e hapjes së ofertave data 23/05/2024, deri në orën 10:30 Mostrat e dorëzuara jashtë këtij afati, nuk do të pranohen nga AK.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për garancinë e mallrave prej 1 viti e cila do të ngarkohet bashkë me dokumentacionet e tjera në tender.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

